



Informim javor për median Dhomat dhe Zyra Administrative

N°35/2022

Hagë, 29/09/2022

PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen gjyqësore kundër Pjetër Shalës, Trupi Gjyqësor njoftoi më 23 shtator se zgjodhi gjykatësen Mapi Feld-Folia si kryegjykatëse. Trupi Gjyqësor I, i cili ka të njëjtën përbërje si edhe në çështjen gjyqësore kundër Salih Mustafës, përbëhet nga tre gjykatës dhe një gjykatës rezervë. Hapi tjetër në këtë çështje do të jetë caktimi i datës për një konferencë përgatitore për gjykimin.

Në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Jakup Krasniqi më 19 shtator dhe vazhdimin e paraburgimit të z. Kadri Veseli më 26 shtator. Në lidhje me këta dy të akuzuar, Gjykatësi konstatoi se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet që të akuzuarit mund të arratisen, të pengojnë ecurinë e procesit ose të kryejnë vepra penale të tjera.

Sa i takon lirimit të përkohshëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arriti në përfundimin se vetëm përmes kornizës për mbikëqyrjen e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara mund të sigurohet kufizimi i komunikimeve të z. Krasniqi dhe të z. Veseli në një mënyrë që i zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe. Në të dy vendimet, Gjykatësi jep edhe arsyet pse arriti në përfundimin se kohëzgjatja e paraburgimit të tyre nuk është joproporcionale.

Pyetje nga gazetarët

